


BIBLIOTEKA

81H-1
P17

Erind Pajo



*Sikur pranë
te kisha
një zog...*

lirika

814-1
PIA

Erind Pajo

Redaktor

ISUE NENAL

Piktur

SHALAH MARIKAL

*Sikur pranë
të kisha
një zog...*



lirika

Shprehjet

Shprehjet

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Erind Pajo

Redaktor

ISUF NELAJ

Piktor

BUJAR MARIKAJ

Sikur pranë
të kisha
një zog...

lirika

Recensues:

Edor Gjergo

Rudolf Marku



FJONGOT PREJ DRITE

Sonte mua nuk më fshet
ndonese pa gjumë jam.
Shoh qytetin
At oq mirë është kthur
me fjongo prej drite
shiritat prej drite,
që vargjet e neomere kërkojnë në bulvard,
fjongove të mëndafshita,
që shuvalin e Viti të Ri lidh
në ngjajmë.

Fjongo prej drite

Sonte mua nuk më fshet,
Fjongot prej drite të qytetit,
në vargjet e neomere
me ato që meser deri të ndodhin
i lidhin, i shpër bashkë...

Së bashku ta ndiesh, kënd qdo natë!
Të ndiesh si fihen ditët me fjongo prej
drite.
Të ndiesh se si shpër të mundshëm
për fshetë të gjitha ditët e jetës vashë.

FJONGOT PREJ DRITE

Sonte mua nuk më flihet
ndonëse pa gjumë jam.
Shoh qytetin.
Ai aq mirë është lidhur
me fjongo prej drite
shiritat prej drite;
që vargjet e neonëve krijojnë në bulevard,
fjongove të mëndafshta,
që dhuratat e Vitit të Ri lidhin,
u ngjajnë.

Sonte mua nuk më flihet;
Fjongot prej drite të qytetit
ngjarjet e sotme
me ato që nesër do të ndodhin
i lidhin, i bëjnë bashkë...

Sa bukur ta ndiesh këtë çdo natë!
Të ndiesh si lidhen ditët me fjongo prej
drite,
të ndiesh se si shirita të ndritshëm
përshtojnë të gjitha ditët e jetës varg.

KORESPONDENCË NGA FUSHA

*Bash këtu, në mes të fushës
njëri-tjetrit i rrinë ballas
një shtyllë betoni e një plep.*

*Plepit i vjen turp
pse ashtu si shtylla
s'është i drejtë.*

*Shtyllës prej betoni,
ngaqë është pa jetë,
s'i vjen dot turp
që ashtu si plepi
ajo nuk ka jetë.*

ROZË, TË KUQE APO TË BARDHA?

Degët e pemëve ishin plot me sythe
dhe unë nuk e dija ç'do të çelnin:
lule të bardha, rozë apo të kuqe.
U vija rrotull pemëve,
por ato s'tregonin,
sekretet i kishin mbyllur nëpër sythe.

Për një çast
i harrova të tëra vogëlsirat e botës, me
radhë;
tjetër gjë më shqetësonte këtë çast:

Në ç'ngjyrë do të çelnin sythat,
në rozë, në të kuqe apo në të bardhë?

1989

ROKË, TË KUOË APO TË BARDHAT
MUZEU NË FORMËN E SHQIPONJËS

I shihni këto pllaka të bardha mermeri?
Janë formuar qyshkur,
ndoshta që në erën e paleozoit.
U shkëputën ca kohë më parë
diku nga gjiri i maleve,
këtu u sollën
për të ndërtuar Muzeun e Heroit.

Janë llogaritur të gjitha pjerrësitë.
Muzeu ka tash pamjen e shqiponjës.
Shqiponjat e gjalla kaq herë në mal
mbi këto pllaka mermeri janë ulur
si të donin që sa më mirë
t'ua mësonin formën.
E tash pllakat e mermerit,
që shqiponja mbi supe kanë mbajtur,
krijojnë vetë pamjen e shqiponjës.

Ja, edhe shqiponjës,
vetëm formën për muze i morëm,
ngjyrën e zezë të përzishme
me ngjyrën e bardhë të mermerit e
dhimbjen e kthyer në forcë! këmbuem,

Shqiponja vigane prej mermeri të
bardhë,
që në mes të Tiranës ka ndalur,
me siguri këtë kërkon të thotë.

ANTIPARALELIZËM

*Guaskë të fortë midhja ka
dhe prapë, brenda saj,
jetën e vet të mbyllur
mezi e mbron.*

*Lëkurë krejt të hollë ka njeriu
por prapë, nën të,
më e madhërishmja jetë gjallon!*